



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:042779

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05578751

**PKR.nr.160/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Krime të Rënda**, në përbërje nga gjyqtarja Sulltane Hoti, kryetare e trupit gjykues, me pjesëmarrjen bashkëpunëtores profesionale Kristina Shtufi, në çështjen penale ndaj të akuzuarve B.R, V.K, B.Z dhe D.A, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe të akuzuarit B.R për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paaautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.82/2018, të datës. 27.03.2020, pas mbajtjes së seancës fillestare me datë 19.03.2024, lidhur me pranimin e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë PP.I.82/2018 të datave 22.02.2024 dhe 23.02.2024, marrëveshjet e arritura mes të Prokurores së shtetit dhe të akuzuarve B.R, me mbrojtësen e tij av.T.Zh, V.K, me mbrojtësin e tij av.Xh.A, B.Z me mbrojtësen e tij av.E.D dhe D.A me mbrojtësin e tij av.B.B, në praninë e prokurores së shtetit B.L, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, me datë 21.03.2024, mori dhe publikisht në prezencën e palëve, shpalli ndërsa me datë 16.04.2024, përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**1.B.R** nga i ati A... dhe nëna S... e gjinisë K..., i lindur me dt..... në Prishtinë, me vendbanim në rr. "H.P" në Obiliq, me numër personal ....., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, merret me bujqësi, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit dhe masën e arrestit shtëpiak nga data 06.07.2018 deri më 05.02.2019.

**2.V.K** nga i ati L...dhe nëna V... e gjinisë P..., i lindur me dt..... në fshatin Qifllakë Komuna e Rahovecit, me vendbanim në rr." Ë.C" në Gjakovë, me numër personal ....., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak nga data 06.07.2018 deri më 05.02.2019.

**3.B.Z** nga i ati N...dhe nëna F... e gjinisë B..., i lindur me dt..... në Ferizaj, ku edhe jeton në rr." B.Sh" pa nr, me numër personal ....., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e arrestit shtëpiak nga data 06.07.2018 deri më datë 05.02.2019.

**4.D.A** me nofkën “J...” nga i ati O... dhe nëna S... e gjinisë S..., i lindur me dt....., në Prishtinë me vendbanim në rr.” V...” nr....., me numër personal ....., i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, i pa punë, i gjendjes së mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e arrestit shtëpiak nga data 06.07.2018 deri më datë 05.10.2018.

## JANË FAJTOR

**Të akuzuarit, B.R, V.K, B.Z dhe D.A,**

### Sepse:

I. Me datën 06.07.2019 rreth orës 20:30, në fshatin Orllloviq, komuna e Obiliqit, saktësisht tek “HIB Petrol”, të akuzuarit pas marrëveshjes paraprake në bashkëkryerje, pa autorizim kanë shpërndarë, shitë, transportuar, dorëzuar, ndërmjetësuar substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope dhe analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, në atë mënyrë që pasi i akuzuari B.R, ka siguruar sasi të mëdha të narkotikëve nga shteti i Maqedonisë dhe Shqipërisë, më pas i ka sjellë në Kosovë e me të cilat i ka furnizuar të akuzuarit D.A, B.Z dhe V.K, me sasi të ndryshme me qëllim të shitjes se tyre dhe paratë e fituara nga shitja ia kanë dorëzuar të akuzuarit B..., ku shumat kryesore nga shitja i ka marrë i akuzuari B..., kurse një përqindje të fituar e kanë ndal për vete, ndërsa gjatë bastisjes dhe kontrollit në shtëpinë e të akuzuarit B.R, në portofolin e tij janë gjetur dy qese të vogla kokainë me peshë **1.6 gram**, në shtëpinë e tij në Obiliq, në rrugën “Hasan Prishtina”, në hyrje mbi një komodinë është gjetur një qese me marihuanë me peshë **4.2 gram**, në dhomë të fjetjes në katin e parë është gjetur një qese e vogël kokainë me peshë **0.8 gram**, në garazhe është gjetur një sasi narkotiku e llojit kokainë me peshë **44.9 gram**, e ndarë në dy pjesë dhe **një peshore digjitale** për matjen e sasisë të vogla të narkotikut të cilat ishin të fshehura në rezervuarin e një kositëse të barit, në veturën e tipit “Mercedes E... BLUETEC”, ngjyrë e zezë metalike, me numër të shasisë EDD2120261A971183, me targa ....., pronë e të akuzuarit B.R, është gjetur një qese e vogël me narkotik e dyshuar për kokainë, me peshë **0.8 gram**, në objektin përcjellës në një dollap është gjetur një sasi e pluhurit me ngjyrë të bardhë e dyshuar si kokainë me peshë **108.5 gram**, në një garazh është gjetur gjithashtu një sasi narkotiku e dyshuar për kokainë me peshë **232.2 gram**, po ashtu rreth orës 18:30 tek i akuzuari V.K, i cili pasi e kishte marrë narkotikun nga i akuzuari B... ka tentuar të ikë me autobus për Gjakovë, por i njëjti është kapur në flagrancë nga policia dhe në xhepin e këmishës së tij janë gjetur **20.5 gram narkotik të dyshuar për kokainë**, kurse tek i akuzuari B.Z janë gjetur **4.3 gram narkotik të llojit kokainë**, po ashtu tek i akuzuari B... janë gjete dhe sekuestruar edhe para në vlerë prej **10,059.00** ( dhjetë mijë e pesëdhjetë e nëntë euro)€, si dhe **10 (dhjetë franga)** Chf, Zvicerane, ndërsa me datën 06.07.2018, rreth orës 14:00, derisa i akuzuri D.A me A.B kanë qenë në veturën “Golf IV”, të cilën e ngiste i pandehuri A..., pronë e babait të tij B.B, pas ndalimit dhe kontrollimit nga ana e policisë, në veturë kanë gjetur dhe sekuestruar substanca narkotike të llojit Kokainë, me peshë prej **10.4 gram**, ndërsa nga ekspertiza e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë-Sektori për ekspertim të substancave të dyshuara narkotike, me nr. AKF/2018-2455/2018-2422, e datës 16.01.2019, ka rezultuar se dëshmia #1-sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike përmban ADMA (Ekstazhi), peshë **0.75 ±0.0001 gram**, Dëshmia #2-sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike Kanabis (marihuanë) që përmban Tetrahidrit kanabinol (THC), pesha neto **3.64±0.0001 gram**, dëshmitë #3,4,1,4,2,7,1,7,2,8,9 dhe 10 –sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike përmbajnë kokainë, pesha neto e përgjithshme: **78.21±0.0001 gram**, dëshmia #5-sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike nuk përmban asnjë

narkotik të rrezikshëm, substancës psikotrope apo prekursor (përmban Fenacetin të përzier me Levamisol), pesha neto: 104.±0.0001 gram, Dëshmia #6- sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike nuk përmban nuk përmban asnjë narkotik të rrezikshëm, substancë psikotrope apo prekursorë, pesha neto: 203.60±0.0001 gram.

-me këtë kanë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

## **I akuzuari B.R,**

**II.** Nga data e pa caktuar e deri me datën 06.07.2018, rreth orës 20:30 minuta, në shtëpinë e tij në rrugën “H.P”, në Obiliq, i pandehuri B.R ka poseduar në shkelje me ligjin e zbatueshen lidhur me armë të tilla, armën e tipit “.....”, me numër serik ....., me një karikator dhe 6 fishek të kalibrit 7.62mm, si dhe dy fishek të kalibrit 7.65mm, të cilat policia i ka gjetur dhe sekuesrtuar, -

-me këtë ka kryer veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4; 7; 17; 20; 21; 31, 41; 42; 43; 45; 46 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-së Nr.04/L-129 dhe neneve dhe neneve 230 par.17 lidhur me paragraf 20, dhe neneve 364, 365 të KPPRK-së, të akzuarit i gjykon:

### **1. Të akzuarit B.R,**

-Për veprën penale në bashkëkryerje si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i shqipton Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, si dhe Dënim me Gjobë në shumën prej tre mijë (3000 €), të cilat dënime do të ekzekutohen pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi,

- Për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, të akzuarit B.R i shqipton dënim me burgim prej katër (4) muajsh, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi,

*Konform neni 80 par.1 dhe 2 nënpar.2.2 të KPRK-së, të akzuarit B.Ri shqipton:*

**Dënim Unik me Burgim** në kohëzgjatje prej një (1) vit e tre (3) muaj, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe masën e arrestit shtëpiak dhe atë nga data 06.07.2018 e deri me datën 05.02.2019 si dhe **Dënim me Gjobë** në shumën prej **tre mijë euro (3000 €)**, të cilën shumë mund ta paguaj deri në 3 (tri) këste mujore në afat kohor prej 3 (tre) muaj, por jo më shumë se 3 (tre) muaj nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

### **2. Të akzuarit V.K,**

-Për veprën penale në bashkëkryerje si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i shqipton **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej **shtatë (7) muaj**, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij

vendimi, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak dhe atë nga data 06.07.2018 deri më datën 05.02.2019, si dhe **Dënim me Gjobë** në shumën prej **njëqind euro (100€)**, të cilin do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### 3. Të akuzuarit B.Z,

- Për veprën penale në bashkëkryerje si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i shqipton **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej **shtatë (7) muaj**, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak dhe atë nga data 06.07.2018 e deri me datën 05.02.2019, si dhe **Dënim me Gjobë** në shumën prej **gjashtë mijë euro (6000 €)**, të cilën shumë mund ta paguaj deri në (tri) këste mujore në afat kohor prej 3 (tre) muaj, por jo më shumë se 3 (tre) muaj nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

### 4. Të akuzuarit D.A,

- Për veprën penale në bashkëkryerje si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i shqipton **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej **nëntë (9) muaj**, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak dhe atë nga data 06.07.2018 e deri me datën 05.10.2018 si dhe **Dënim me Gjobë** në shumën prej **tremijë euro (3000 €)**, të cilën shumë mund ta paguaj deri në 3 (tri) këste mujore në afat kohor prej 3 (tre) muaj, por jo më shumë se 3 (tre) muaj nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin e shqiptuar me gjobë, gjykata konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo 20 (njëzet) Euro me një ditë burgim.

-Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguajnë shpenzimet aq sa do të llogariten sipas shpenzimeve të gjykatës, ashtu që në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguajë shumën me nga njëqind Euro **(100€)**, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajnë secili veç e veç shumën me nga pesëdhjetë Euro **(50€)**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 83 par.1 të KPRK-së, koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe masën e arrestit shtëpiak për të akuzuarit do t'iu llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

**II.** Në mbështetje të nenit 276 par.2 nënpar.2.4 të KPPRK-së, si dhe nenit 273 par.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082, ndaj të akuzurve urdhërohet edhe: **Konfiskimi i sendeve dhe atë substancat narkotike si në vijim:**

#### a). Nga i akuzuari B.R:

- dy qese kokainë me peshë prej 1.6 gram,
- një qese marihuanë me peshë prej 4.2 gram,
- një qese kokainë me peshë prej 0.8 gram,
- substancë narkotike-kokainë me peshë prej 44.9 gram.
- një qesë koakinë me peshë prej 0.8 gram,
- sasia e kokainës me peshë prej 108.5 gram,

- sasia e kokainës me peshë prej 232.2 gram.
- Një peshore digjitale, me ngjyrë të hirit, e cila është gjetur te i pandehuri B.R,

Nga i akuzuari V.K;

- një sasi e kokainës me peshë prej 20.5 gram.

Nga i akuzuari B.Z;

- një sasi e kokainës me peshë prej 4.3 gram.
- një sasi e kokainës me peshë prej 10.4 gram.
- një sasi e marihuanës-kanabis me peshë prej  $0.75 \pm 0.0001$  gram,
- një sasi e kokainës me peshë prej  $3.64 \pm 0.0001$  gram,
- një sasi e kokainës me peshë prej  $78.21 \pm 0.0001$  gram.

b). Kartëmonedhat në vlerë prej 1,059 euro, pronë e të akuzuarit B.R si në vijim:

Valuta në vlerë prej 500 euro, me numër X04990858976.  
Valuta në vlerë prej 100 euro, me numër X14125917251  
Valuta në vlerë prej 100 euro, me numër X08740864172  
Valuta në vlerë prej 50 euro, me numër EB0560952207  
Valuta në vlerë prej 50 euro, me numër X31547142641  
Valuta në vlerë prej 50 euro, me numër SD5100173003  
Valuta në vlerë prej 50 euro, me numër EA5990861881  
Valuta në vlerë prej 50 euro, me numër X89808615416  
Valuta në vlerë prej 50 euro, me numër RA2219885169  
Valuta në vlerë prej 10 euro, me numër YA4792524794  
Valuta në vlerë prej 10 euro, me numër PA4368172265  
Valuta në vlerë prej 10 euro, me numër X32278090115  
Valuta në vlerë prej 10 euro, me numër YA3555592829  
Valuta në vlerë prej 5 euro, me numër VA8690398382  
Valuta në vlerë prej 5 euro, me numër ZB4227685872  
Valuta në vlerë prej 5 euro, me numër YA3108073724.  
Valuta në vlerë 10 Franga Zvicerane, me numër 16B6088085.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, urdhërohet shkatërrimi i lëndëve narkotike të sekuestruara, substanca të kundërligjshme të përdorura në kryerjen e veprave penale.

**III. URDHËROHET** Agjensioni për Administrimin e Pasurisë që të bëjë menaxhimin e pasurisë së konfiskuar konform dispozitave ligjore.

**IV.** Gjykata në mbështetje të nenit 276 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, si dhe nenit 374 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nxjerr këtë:

URDHËR-Urdhërohet konfiskimi i përhershëm i sendeve në vijim dhe atë: Një revole e tipit “TT m57”, me numër serik 26021, me një karikatorë dhe 6 fishekë të kalibrit 7.62 mm si dhe dy fishekë të kalibrit 7.65 mm nga i akuzuari B.R, si mjet i kryerjes së veprës penale. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, revolva e tipit “TT m57”, me numër serik 26021, me një karikatorë dhe 6 fishekë të kalibrit 7.62 mm si dhe dy fishekë të kalibrit 7.65 mm, duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Prishtinë, pasi të vërtetohet se të njëjtat nuk janë përdorur në ndonjë rast tjetër penal.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.82/2018, të datës 27.03.2020, kundër të akuzuarit B.R, V.K, B.Z, D.A dhe A.B, për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe ndaj të akuzuarit B.R, për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ndërsa me datën 29.02.2024 prokuroria i ka dorëzuar gjykatës Marrëveshjet për pranimin të fajësisë me shenjen PP.I.82/18 të datës 22.02.2024 dhe 23.02.2024, marrëveshjet e arritura mes të Kryeprokurorit Prokurorisë dhe Prokurores së shtetit në njëri anë si dhe të akuzuarve B.R, me mbrojtësen e tij av.T.Zh, V.K, me mbrojtësin e tij av.Xh.A, B.Z me mbrojtësen e tij av.E.D dhe D.A me mbrojtësin e tij av.B.B, në anën tjetër.

Me aktvendim të veçantë me shenjen PKR. nr.160/2020 të datë 14.03.2024, gjykata e ka Hedhë Pjesërisht Aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, me shenjen PP.I.nr.82/2018, të datës. 27.03.2020, dhe ka Pushuar procedure penale, ndaj të akuzuarit A.B për veprën penale në bashkëkryerje Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që prokurorja e shtetit është tërhequr nga ndjekja penale me parashtrësën e datës 11.03.2024 ndaj të akuzuarit A.B, ndërsa ka vazhduar procedurën penale ndaj të akuzuarve B.R, V.K, B.Z dhe D.A, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe të akuzuarit B..R për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata caktoi dhe mbajti seancën dëgjimore në lidhje me pranimin e marrëveshjeve të fajësisë me datë 19.03.2024, në të cilën Prokurorja e Shtetit në pika përmbledhëse e elaboroi dhe i propozoj gjykatës që marrëveshjet si të tilla të arritura mes Prokurorisë dhe të akuzuarve B.R, V.K, B.Z dhe D.A me mbrojtësit e tyre, t'i aprovojë dhe të njëjtat të jenë pjesë e shkresave të lëndës si dhe qëndrojë pranë dënimit të rekomanduar në marrëveshje për shkak të natyrës së veprave penale.

Mbrojtësja e të akuzuarit B.R av.T.ZH deklaroi se me Prokuroren e Shtetit kishin lidhur marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe janë pajtuar me dënimin e shqiptuar dhe mbesin pranë marrëveshjes, mirëpo e lutin gjykatën meqenëse nuk është e lidhur për dënimin e që ndaj B.R të aplikojë zbutjen e dënimit me gjobë duke e pasur parasysh se i njëjti së fundmi kishte humbur babin dhe i kishte mbetur nëna e cila është në moshë të shtyrë, bashkëshortja dhe fëmija i mitur për të cilin kujdeset, me propozim që të ketë parasysh propozimin tyre dhe ta merr në konsideruar me rastin e matjes së dënimit.

I akuzuari B.R deklaroi se e mbështet fjalën e mbrojtëses së të tij në lidhje me marrëveshjen e negociuar mbi pranimin e fajësisë, shton se ashtu siç ka njoftuar edhe mbrojtësja e tij nga rasti i humbjes së prindërit të tij dhe nëna i kishte mbetur e vetme dhe është mbajtës i vetëm i familjes dhe meqenëse e nëna e tij është në moshës së shtyrë ka nevojë për kujdesin e tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.K. av. Xh.A deklaroi se pas marrëveshjes së lidhur në mes prokurorisë së rastit ishte dakord që të mbrojturit të tij t'i shqiptohet dënimi i cili ishte cekur në marrëveshje,

prej 7 muajsh si dhe dënim tjetër alternativ nuk kishte pasur prandaj qëndrojnë pranë marrëveshjes dhe e lusin gjykatën që të njëjtën ta aprovoj në tërësi.

I akuzuari V.K deklaroi se e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij në lidhje me marrëveshjen e negociuar mbi pranimin e fajësisë.

Mbrojtësja e të akuzuarit D.A av.E.D deklaroi se lidhur me aktakuzën PP.I.nr.82/2018, të datës. 27.03.2020, e cila është arritur duke respektuar kodin e procedurës penale përkatësisht nenin 230 par.1 pika 1.1 1.2 dhe 1.3, duke pasur për bazë se marrëveshja ishte nënshkruar duke respektuar KPPK-ë dhe vullnetin e palës përkatësisht të akuzuarit D.A, kërkoj nga gjykata që ta aprovoj marrëveshjen e lidhur me prokurorin gjithashtu dhe tek shqiptimi i dënimit të aprovoj minimumin e propozuar me marrëveshje po ashtu me qenë se gjykata i kishte duart e lira që të shkojë edhe nën minimum do të ishte i favorshëm një dënim me gjobë për të mbrojturin e saj sepse me dt.18.03.2024 në zyrën e ndërmjetësimit, ishte arritur marrëveshja ndërmjet të mbrojturit të saj dhe ish bashkëshortes së tij që besimi i fëmijës së tyre të mitur i moshës 11 vjeçare t'i kaloj të mbrojturit të saj.

I akuzuari D.A deklaroi se e mbështet fjalën e mbrojtëses së tij në lidhje me marrëveshjen e negociuar mbi pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.Z av. B.B deklaroi se edhe i mbrojturi i tij kishte arritur marrëveshjen e mbi pranimin e fajësisë në prokurori dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtën ta aprovoj ndërsa sa i përket dënimit të rekomanduar të shqyrtoj mundësinë që t'i shqiptoj të mbrojturit të tij një dënim me gjobë më të ulët nga ajo se çka është rekomanduar në këtë marrëveshje për faktin se dënimin prej 6000 deri 7000 euro është dënim tejet i lartë dhe i pazakontë në praktikën gjyqësore e duke marr parasysh edhe kushtet ekonomike të mbrojturit të tij, i njëjti nuk punon dhe konsideroi se qëllimi i dënimit do të arrihet edhe me dënim me të ulët.

I akuzuari B.Z deklaroi se e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij në lidhje me marrëveshjen e negociuar mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata gjatë shqyrtimit të pranimit apo mospranimit të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, pas dëgjimit të prokurores së shtetit, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, e konform nenit 230 par.17 dhe 18 të KPPRK-së, përcaktoi se të akuzuarit në tërësi kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe se nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që ta pranojnë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë dhe nuk ekziston asnjë rrethanë e paraqitur në nenin 248 par.1 të këtij Kodi.

Gjykata pas marrjes së mendimit të prokurores së shtetit, mbrojtësve dhe të akuzuarve dhe pasi që është bindur plotësisht se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara në paragrafin e 17 të nenit 230 të KPPRK-së, konform nenit 230 par.20 lidhur me paragraf 17 të KPPRK-së, me AKTVENDIM pranoi Marrëveshjet për pranimin e fajësisë PP.I.nr.82/2018, të datave 22.02.2020, dhe 23.02.2024, të lidhura ndërmjet Kryeprokurorit të Shtetit dhe Prokurores së Shtetit në njërin anë si dhe të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre në anën tjetër dhe urdhëroi që Marrëveshjet të vendosen në shkresat e lëndës së kësaj gjykate pa asnjë vërejtje.

Nga Marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe deklaratat e të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive

dhe objektive të veprave penale sipas aktakuzës PP.I.nr.82/2018, të datës. 27.03.2020, edhe atë për të akuzuarit B.R, V.K, B.Z dhe D.A për veprën penale në bashkëkryerje Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe për të akuzuarin B.R, edhe për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, rikujton se sipas nenit 22 të KPRK-së, dashja është element subjektiv i veprës penale e cila mund të nxjerrët nga rrethanat faktike të rastit. E nga rrethanat e rastit konkret dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, po ashtu bazuar edhe në shkresat e lëndës kemi arritur në përfundim se të akuzuarit e lartcekur, veprat e lartcekura penale, i kanë kryer me dashje të drejtpërdrejtë apo dashje direkte.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve nga të akuzuarit D.A, B.Z dhe V.K të datës 06.07.2018; Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të gjëseneve për të akuzuarin B.R të datës 07.07.2018; Procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave i datës 11.07.2018; Raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër referues AKF/2018-2455/2018-2421 të datës 10.08.2018; Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 06.07.2018; Raporti i ekzaminimit të bisedave telefonike i datës 27.02.2019; Fotografitë e vendit të ngjarjes, të cilat gjenden në shkresat e lëndës; Raporti i analizës së bisedave telefonike e datës 27.07.2018; Lista e plotë e parave të gjetura gjatë bastisjes me dt.11.07.2018; Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 06.07.2018; Foto albumi i datës 11.07.2018; Raporti informues për bastisje i datës 13.07.2018; Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 13.07.2018; Fotoalbumi që gjendet në shkresat e lëndës i datës 06.07.2018 i veturës Golf VI, Ekspertiza e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë-Balistikë, me nr. AKF-2018-0223 e datës 10.08.2018, Ekspertiza e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë-Sektori për ekspertim të substancave të dyshuara narkotike me nr. AKF/2018-2455/2018-2422 të datës 16.01.2019 si dhe shkresat tjera të cilat gjenden në dosjen e kësaj lënde, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprave penale të lartcekura. Andaj, gjykata të njëjtit i shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht janë të përgjegjshëm dhe i gjykoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesve sipas nenin 69 par.2 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesve, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së dhe qëllimi i dënimit me kusht e që është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së. Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, e rekomanduar në Marrëveshjen e pranuar nga gjykata, e njëjta mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 73 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese për të katër të akuzuarit mori pranimin e fajësisë, gjendjen ekonomike, e të gjitha këto të përfshira në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, në të cilën janë dakorduar për vendimin mbi dënimin dhe lartësinë e tij, e duke pasur parasysh se gjykata e pranoi Marrëveshjen për pranimin e fajësisë, marrë parasysh se për veprën penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, parashihet dënim me gjobë dhe dënim me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet



burgim, ndërsa për të akuzuarin B.R edhe për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, për të cilën parashihet dënim me gjobë dhe dënim me burgim deri në pesë (5) vjet burgim, ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka vlerësuar dashjen e të akuzuarve të kjo vepër penale, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial nga të akuzuarit në këtë vepër penale, motivin me të cilin kanë vepruar, mënyrën e kryerjes së veprës penale, se veprat e tilla penale paraqesin një rrezikshmëri të lartë shoqërore, intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, po ashtu si rrethanë posaçërisht rënduese mori karakteristikat personale dhe sjelljen e mëparshme të akuzuarve kjo për faktin se bazuar në regjistrin elektronik të lëndëve nga kjo Gjykatë, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, del se të njëjtit kanë rënë ndesh me ligjin edhe më herët, pasi që në emrin e të akuzuarve janë të evidentuara edhe disa vepra të ndryshme penale për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtor dhe janë dënuar, dhe të njëjtit janë përsëritës të veprave penale të tilla edhe të kësaj natyre, andaj duke u nisur nga të gjitha këto gjykata me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal të akuzuarve iu shqiptoi dënimet të precizuara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, dhe se duke qenë e bindur se me këto dënime do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandalojë kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesve sipas nenit 73 par.2 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesve, me bindje se dënimet e tilla do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPPRK-së.

Vendimi për shumën e të hollave në emër të taksës për Programin e Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3, nënpar.3.2 të Ligji nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi lidhur me llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak është marrë konform nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskimin është marrë konform nenit 273 par.5 lidhur me nenin 374 par.3 të të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082, e lidhur me nenin 276 par.2 nënpar.2.4 të Kodit të Procedurës Penale.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**PKR.nr.160/2020 datë 16.04.2024**

Numri i lëndës: 2020:042779  
Datë: 16.04.2024  
Numri i dokumentit: 05578751

**Bashkëpunëtore Profesionale,  
Kristina Shtufi**

**Kryetarja e trupit gjykues  
Sulltane Hoti**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.